

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

*Erjona Suljoti, Sofika Note, Anjeza Gazidede dhe Medvin Shehu
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

KORRIK 2024

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J E

<i>HYRJE</i>	4
<i>PËRMBLEDHJE</i>	5
<i>1. KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT</i>	6
<i>2. KREDIA PËR BIZNESE</i>	9
<i>3. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	14

HYRJE

Ky material paraqet një panoramë të aktivitetit kreditues në vend dhe në rajon. Në të analizohen të dhënat monetare, normat e interesit si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Më konkretisht, statistikave kryesore të analizuar në material janë: a) statistikave të flukseve reale¹ për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikave për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare dhe normat e interesit për aktivitetin kreditues për vendet e rajonit.

Në vendet e rajonit janë përfshirë në analizë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Kosova (KS), Mali i Zi (MNE), Rumania (RO), Serbia (SR), Polonia (PL), Hungaria (HU), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 29 korrik 2024, të cilat përfshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend deri në muajin qershor 2024, dhe të dhënat e Vrojtimin të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2024. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin maj 2024.

¹ Të dhënat e kredisë merren nga bilanci i bankave dhe i referohen financimit për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Nga viti 2022, analiza e portofolit të kredisë bazohet në setin e ri të informacionit të përgatitur nga Departamenti i Statistikave Financiare në linjë me metodologjinë e BQE-së për flukset "reale" të kredisë- të rregulluara si nga lëvizjet e kursit të këmbimit ashtu edhe nga kreditë e nxjerra nga bilanci.

PËRMBLEDHJE


Kredia për sektorin privat është zgjeruar me ritme të larta në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, duke reflektuar një kërkesë të lartë për financim nga sektori privat, kushtet e favorshme të financimit, si dhe gatishmërinë e bankave për të përmbushur këtë kërkesë. Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe, vihet re:

- **Kredia për biznese** ka shfaqur një përmirësim të fortë duke u rikthyer në kontribut-dhënës të kryesor në rritjen e kredisë për sektorin privat. Sipas madhësisë së bizneseve, është biznesi i madh ai që ka përcaktuar dinamikën pozitive të këtij segmenti, ndërkohë që kredia për biznesin e vogël e të mesëm është ngadalësuar lehtësisht. Në këndvështrimin sektorial, bankat kanë rritur financimin për bizneset në të gjithë sektorët e ekonomisë. E veçanta e këtij gjashtëmujori është rikthimi i kontributit pozitiv të kreditimit për sektorin e industrisë.
- **Kredia për individë** është rritur gradualisht përgjatë pjesës së parë të vitit, duke reflektuar një zgjerim të shpejtë të portofolit të kredisë në lekë dhe tkurrje të atij në monedhë të huaj. Kjo dinamikë është përkrahur edhe nga thellimi i diferencës së normave të interesit të kredisë. Kërkesa e individëve për kredi është rritur më tej.
- **Kushtet çmim dhe joçmim të ofertës për kredi** shfaqen më të lehtësuara në gjashtëmujorin e parë, duke reflektuar tolerancën më të lartë të bankave ndaj rrezikut të kreditimit në kushtet e primeve të rrezikut të kontrolluar dhe perspektivës pozitive ekonomike. Megjithatë në një këndvështrim më afatgjatë, ato mbeten pranë niveleve mesatare të dy-tre viteve të fundit.
- **Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit** ka rikuperuar rritjen në gjysmën e parë të vitit, e nxitur kryesisht nga kredia për individë. Kredia për biznese ka dhënë gjithashtu sinjale gjallërimi. Në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit, kredia ka pasur një performancë të mirë, ku Shqipëria spikat për norma të larta të rritjes së saj. Normat e interesit të kredive kanë filluar të bien në disa prej vendeve, në reflektim të uljeve të normave bazë. Në vazhdim të vitit pritët rikuperim i mëtejshëm i rritjes së kredisë, nxitur nga rënia e normave të interesit, lehtësimi i kushteve të kreditimit dhe përmirësimi i kërkesës për kredi, investime dhe për pasuri të paluajtshme.

1. KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT


Kredia për sektorin privat në vend është rritur me ritme të larta, duke mbartur dinamikat pozitive të nisura nga fundi i vitit të kaluar. Rritja e gjashtëmujorit të parë është me bazë të gjerë, në përgjigje të kërkesës së shtuar për financim nga sektori privat dhe të kushteve të lehtësuara të ofertës për kredi. Edhe në prizmin rajonal, Shqipëria dallon për norma të larta të rritjes së kredisë. Në vazhdim të vitit, sikurse në rajon edhe në Shqipëri pritet një përmirësim i mëtejshëm i rritjes së kredisë, me një kontribut të shtuar nga kredia për investime dhe ajo hipotekare, stimuluar edhe nga ulja e normave të interesit.

Aktiviteti kreditues në vend është zgjeruar me ritme të larta në gjysmën e parë të vitit 2024, duke reflektuar rritjen e kërkesës për financim nga agjentët ekonomikë dhe kushte të favorshme të ofertës për kredi. Më konkretisht, zgjerimi i investimeve dhe konsumit privat, forcimi i besimit dhe gjendja e mirë e likuiditetit dhe balanceve të sektorit privat kanë rritur kërkesën për financim. Nga ana tjetër, bankat janë treguar të gatshme për të financuar këtë kërkesë dhe kanë mbajtur normat e interesit në nivele të ulëta dhe kushtet e kreditimit në nivele të favorshme. Kështu, portofoli i kredisë për sektorin privat shënoi një normë mesatare të rritjes vjetore prej 13%, ose rreth dy herë më të lartë se ajo e shënuar një gjashtëmujor më parë. Në përmirësim është shfaqur edhe raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së, i cili shënoi 31.5%, ose 1 pp më shumë se fundi i vitit 2023.



Rritja e kredisë është mbështetur nga zgjerimi i ndjeshëm i kredisë për biznese, i cili është kthyer në kontribut-dhënës në kryesor në zgjerimin e portofolit të kredisë totale. Nga ana tjetër, kredia për individë ka shfaqur një rritje të qëndrueshme. Kredia për biznese përfaqëson rreth 18.7% të PBB-së duke qëndruar në këto nivele për më shumë se një vit- ndërsa kredia për individë vlerësohet rreth 12.8% të PBB-së.


Grafik 2. Ecuria e kredisë për sektorin privat sipas agjentëve ekonomikë dhe afatit



Sipas afatit të maturimit të kredisë, zgjerimi i portofolit është mbështetur nga të tre kategoritë, por rritjen më të ndjeshme e kanë dhënë kreditë me afate të gjata maturimi në përputhje edhe me mbulimin e nevojave për investime si të bizneseve ashtu edhe të individëve. Kështu, norma vjetore e rritjes së kredive afatgjata shënoi normën më të lartë të rritjes me rreth 14%, ndërkohë që kredia afatmesme dhe afatshkurtër u rritën me përkatësisht 12% dhe 10% krahasuar me të njëjtën periudhë. Si pasojë e këtyre dinamikave, shpërndarja strukturore e portofolit ka mbetur e pandryshuar në vitin e fundit, dhe kredia afatgjatë dominon portofolin e kredisë duke përfaqësuar rreth 64% të totalit.

Kredia për sektorin privat në vendet e Evropës Qendrore (EQ) dhe ato të Ballkanit është rimëkëmbur në pjesën e parë të këtij viti, pas ngadalësimit të shënuar prej gjysmës së dytë të vitit 2022. Shenjat e para të rikuperimit të rritjes së kredisë u dhanë që në pjesën e dytë të vitit që kaloi. Në pothuajse të gjitha vendet, ka qenë zgjerimi i kredisë për individë që ka nxitur rritjen e kredisë për sektorin privat në këtë pjesë të parë të vitit. Shenja të rikuperimit ka dhënë edhe kredia për biznese, por kjo pritet të confirmohet më tej gjatë vitit. Vendet e Ballkanit vazhdojnë të kenë një performancë më të mirë krahasuar me vendet e EQ, ku Shqipëria renditet mes vendeve me rritjen më të shpejtë të kredisë, si për bizneset, ashtu edhe për individët.


Grafik 3. Ecuria e kredisë për sektorin privat në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës Qendrore



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; llogaritje të stafit.

Sipas rezultateve të Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues (VAK) për vendet e Evropës Qendrore e Juglindore, të kryer nga Banka Evropiane e Investimeve², ecuria e dobët e kreditimit në këto vende pas fillimit të luftës Ukrainë-Rusi ka reflektuar kryesisht kushtet e shtrënguara të ofertës. Këto të fundit u shtrënguan fillimisht nga pasiguritë që shoqëruan lindjen e konfliktit, e më pas nga rritja e inflacionit dhe ngadalësimi ekonomik. Kushtet e kreditimit ruajtën natyrën shtrënguese edhe për periudhën tetor 2023 – mars 2024.

Grafik 4. Normat bazë dhe kërkesa e oferta për kredi në vendet e Ballkanit dhe të EQ



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI; llogaritje të stafit.

Nga ana tjetër, kërkesa për kredi është raportuar gjithmonë në rritje. Për gjatshëmujorin e ardhshëm, bankat ndërkombëtare që operojnë në vendet e Ballkanit dhe të EQ raportojnë lehtësim të kushteve të ofertës dhe rritje të mëtejshme të kërkesës për financim, që pritet të materializohet në përsheptim të rritjes së kredisë në muajt e ardhshëm.

² Për më shumë detaje, mund t'i referoheni materialit të mëposhtëm:

https://www.eib.org/attachments/lucalli/20240113_economics_cesee_bls_2024_h1_en.pdf


Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar ecurinë e dobët të kredisë në shumë prej vendeve gjatë vitit që kaloi është edhe rritja e normave të interesit. Këto të fundit kanë ndjekur rritjet e normës bazë nga bankat qendrore, në përgjigje të normave të larta të inflacionit. Vendet me inflacion më të lartë e me rritje më agresive të normës bazë ishin ato të EQ, në të cilat aktiviteti kreditues u ngadalësua në mënyrë të ndjeshme, duke shënuar edhe tkurrje. Shembuj të ngjashëm në Ballkan kanë qenë Rumania dhe Serbia. Duke filluar nga tremujori i fundit i vitit 2023, disa nga bankat qendrore kanë filluar të ulin normat bazë të interesit, duke ndihmuar në rigjallërimin e kreditimit në këto vende gjatë vitit 2024.

2. KREDIA PËR BIZNESE

Financimi i bizneseve nga bankat është rritur ndjeshëm në gjashtëmujorin e parë të vitit, duke reflektuar gatishmërinë më të lartë të bankave për financimin e kërkesës së shtuar të bizneseve për kreditim. Gjatë gjashtëmujorit të parë, bankat kanë kredituar kryesisht biznesin e madh dhe sektorin e tregtisë. Ecuria e kredisë për biznese në vendet e rajonit evidenton përmirësimin e normave të rritjes krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar.


Kredia për biznese u rrit me 12% mesatarisht në gjashtëmujorin e parë të vitit, duke shënuar një rritje vjetore rekord gjatë dekadës së fundit. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, kjo rritje ishte rreth 2 herë më e lartë. Tendencat e vërejtura në fund të vitit 2023 janë mbartur edhe në fillim të këtij viti: kështu mund të themi se ende vijon zhvendosja drejt financimit në lekë dhe dominon rritja e kredisë për financimin e investimeve.

Kredia në lekë për biznese vijoi rritjen me norma dyshifrore prej 17.4% në gjashtëmujorin e parë, ndërkohë që zhvillimet e tremujorit të dytë treguan rigjallërimin e kredisë në valutë. Kjo e fundit shënoi një normë të përmirësuar rritjeje duke kulmuar në 12% në muajin qershor. Ndërkohë fenomeni i zhvendosjes së portofolit të kredisë nga euro në lekë ka vijuar edhe gjatë kësaj periudhe, por në nivele shumë më të ulëta se ai i vërejtur gjatë vitit 2023.




Sipas madhësisë së bizneseve, ka qenë kredia për biznesin e madh ajo që ka ndikuar në përshejtimin e normave të rritjes. Kredia për biznesin e madh, mbasi shfaqti stanjacion në dy vitet e fundit, ka treguar një rritje të fortë të financimit nga bankat në gjashtë muajt e parë të vitit. Ajo shënoi një nga nivelet më të larta të rritjes prej 18%, nga 2% në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023. Zgjerimi vjetor i kredisë së biznesit të madh reflekton, ndër të tjera, edhe financimin e projekteve infrastrukturore të qeverisë. Paralelisht, portofoli i kredisë për biznesin e vogël dhe të mesëm u rrit me 6% gjatë pjesës së parë të viti 2024, normë kjo lehtësisht më poshtë se rritja prej 7% e shënuar në vitin 2023. Brenda kësaj kategorie duket se ishin bizneset e mesme ato që kanë shfaqur ngadalësimin më të ndeshëm të kredisë për financimin e nevojave të tyre.

Bankat kanë rritur financimin e bizneseve në të gjithë sektorët e ekonomisë, por rritja më e lartë vihet re në sektorin e tregtisë. Kredia për këtë sektor u rrit me 13%, dyfishi i normës së rritjes të vërejtur në pjesën e dytë të vitit 2023. Brenda vetë sektorit vihet re një kontribut i ngjashëm me vitin e kaluar të degës së turizmit, dhe një kontribut i rritur nga dega e transportit. Ndërkohë, një ndikim pozitiv në rritjen e portofolit të kredisë për biznese ka dhënë edhe sektori i industrisë; ritmet e rritjes së të cilit prej 10% rikthyen në terren pozitiv kontributin e këtij sektori. Brenda këtij sektori është dega e industrisë përpunuese, e cila fitoi më shumë financim nga bankat. Po ashtu, financimi i bankave për bizneset e sektorit të ndërtimit ka qenë pozitiv dhe i qëndrueshëm. Kredia për këtë sektor u rrit me 6%, një normë kjo e ngjashme me mesataren e gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2023. Kreditimi për sektorin e bujqësisë shfaqti rritje dyshifrore prej 12%. Megjithatë në rritje, kontributi i tij ndaj rritjes së kredisë për biznese është pothuajse i papërfillshëm. Këto zhvillime në portofolin e kredisë për biznese janë përgjithësisht në linjë me aktivitetin ekonomik në vend.



Interesat e kredisë në lekë për biznese në gjysmën e parë të këtij viti janë luhatur duke shënuar një prirje të lehtë rritëse kryesisht në tre muajt e fundit. Rritja ka qenë minimale dhe niveli i interesave mbetet i ulët duke qenë kështu favorizues në aktivitetin kredidhënës. Interesat e kredisë në euro janë shfaqur të qëndrueshme këtë 6-mujor pas rritjeve të realizuara vitin e kaluar në reflektim të rritjes së normës bazë të euros nga BQE-ja gjatë asaj periudhe.


Norma mesatare e interesit për kreditë e reja në lekë për biznese në tremujorin e dytë rezultoi 6.8% nga 6.6% që ishte në tremujorin e parë dhe 6.7% vitin e kaluar. Interesat janë rritur lehtas tek të tre kategoritë ndonëse ishte kategoria e kredive mbi 140 mln lekë ajo që ndikoi më shumë në muajt e fundit. Interesi mesatar për këto kredi arriti 6.7% në tremujorin e fundit nga 6.5% dhe 6.1% në tremujorët paraardhës. Kategoria e kredive me shuma deri 35 mln lekë e cila përafron biznesin e vogël ka regjistruar rritje minimale por të vazhdueshme që prej tremujorit të fundit të vitit të kaluar. Interesi për këtë kategori shënoi 7.7% në këtë tremujor nga 7.4% dhe 7.2% që shënonte në dy tremujorët paraardhës. Kostoja e financimit për likuiditet afatshkurtër ka rezultuar në rritje ku interesat për overdraft dhe kapital qarkullues në tremujorin e dytë rezultuan 6.4% nga 6.0% në tremujorin e parë dhe 6.3% vitin e kaluar. Analiza sipas fiksimit fillestar të interesit tregon se tek kredia me normë fillestare të fiksuar deri në një vit ka vijuar ulja edhe gjatë këtij tremujori. Ecuri të kundërt ka shfaqur ndërkohë kredia me normë të fiksuar mbi një vit, interesat e së cilës janë rritur. Interesat tek këto kategori shënuan respektivisht 6.3% dhe 7.6% këtë tremujor, nga 6.5% dhe 6.9% në tremujorin e parë dhe 6.7% dhe 6.4% që ishin në tre muajt e fundit të vitit të kaluar.



Norma e interesit për kreditë në euro të bizneseve në tremujorin e dytë rezultoi 7.0%, duke qenë e njëjtë me tremujorin e parë dhe më lart se 6.6% e gjysmës së dytë të vitit të kaluar. Analiza sipas madhësisë së kredisë evidenton se krahasuar me tremujorin e parë interesat janë ulur lehtas tek kreditë për shuma deri 250 mijë euro (7.1% nga 7.2%) dhe janë rritur me të njëjtën vlerë (7.0% nga 6.9%) tek kategoria e kredive mbi këtë shumë. Duhet theksuar se

interesat tek kjo kategori kanë shënuar rritje minimale por të vazhdueshme prej mëse një viti. Rritjet e normës bazë për euron nga ana e BQE-së vitin e kaluar janë reflektuar plotësisht tek interesat e kredisë në euro tek bizneset.


Analiza sipas fiksimit fillestar të interesit tregon se në gjysmën e parë të këtij viti, kredia me normë të fiksuar deri në një vit ka shënuar rritje interesash më të lartë se ajo me fiksimit fillestar mbi një vit. Interesat për overdraft dhe kapital qarkullues ndërkohë kanë shfaqur prirje të lehtë rënëse në pjesën e parë të këtij viti. Interesat për financim afatshkurtër rezultuan 6.1% në tremujorin e dytë nga 6.3% një tremujor më parë dhe 6.0% mesatare e vitit të kaluar.



Nën tryshinë e shtuar nga konkurrenca në sistemin bankar, të përkrahura nga pozitat dhe bilancet e shëndetshme të vetë bankave, si dhe të nxitura nga një perspektivë ekonomike pozitive, bankat kanë ofruar kushte kreditimi më të lehtësuara për bizneset.


Në vija të përgjithshme përqasja e bankave në kreditimin e bizneseve gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 është më akomoduese nga ajo e vërejtur në gjysmën e dytë të vitit 2023. Standardet e kreditimit në huatë e akorduara për bizneset mbetën të pandryshuara në tremujorin e dytë, për të pestin tremujor me radhë. Megjithatë në tremujorin e dytë të vitit, bankat perceptuan një situatë makroekonomike më të favorshme dhe një perspektivë më optimiste për treguesit kryesorë makroekonomikë. Kushtet dhe termat e kreditimit për bizneset u lehtësuan, për herë të parë pas nëntë tremujorësh. Elementet joçmimformuese të kredisë për bizneset nuk shfaqën ndryshime të mëdha në këtë tremujor, me përjashtim të kushtëzimeve të marrëveshjes së kredisë së nënshkruar mes palëve. Ky tregues vijoi të shënojë balancë neto negative, megjithatë në nivele më të ulëta krahasuar me mesataren e shënuar një vit më parë.

Grafik 9. Kushtet joçmim për kreditë e reja të bizneseve



Ecuria e **kredisë për biznese në vendet e rajonit** ka qenë heterogjene në pjesën e parë të këtij viti. Në vija të përgjithshme, evidentohet një pikë kthese për pjesën më të madhe të vendeve dhe përmirësim i rritjes krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Mes vendeve të Ballkanit, rritja e kredisë për biznese vijon të jetë e fortë në Shqipëri, Kosovë dhe Bullgari, ndërsa mes vendeve të EQ-së dallohet Çekia. Kredia për biznese ka filluar të rikuperojë rritjen në Serbi dhe Mal të Zi, por është ngadalësuar më tej në Rumani, Kroaci dhe Hungari. Sipas VAK-ut të BEI-t, në vazhdim të këtij viti pritet një përmirësim më i dukshëm në ecurinë e kredisë për biznese, me një kontribut të shtuar nga kredia për investime.

Grafik 10. Kredia për bizneset në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës Qendrore




Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI; llogaritje të stafit.

Normat e interesit për kreditë e reja për biznese kanë shënuar rënie në disa prej vendeve të rajonit, në reflektim të reduktimit të normave bazë të interesit nga bankat qendrore. Rënia e interesave të kredive ka qenë e spikatur

veçanërisht tek vendet e EQ-së, në të cilat cikli zbritës i normave bazë ka filluar që në gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Megjithatë, nivelet aktuale të interesave në këto vende mbeten të larta krahasuar me nivelet e tyre përpara fillimit të ciklit shtrëngues të politikës monetare.

Ndër vendet e Ballkanit - Serbi, Rumani, Shqipëri dhe në vendet që kanë adoptuar euron (Kroaci, Mal i Zi, Kosovë), reduktimi i normave bazë të interesit ka filluar pas muajit prill dhe nuk është materializuar ende plotësisht në norma më të ulëta të interesit të kredive. Uljet e mëtejshme të normave bazë që projektohen të ndodhin në vazhdim pritet të sjellin reduktim të interesave, duke nxitur rikuperimin e mëtejshëm të kredisë.




3. KREDIA PËR INDIVIDË

Portofoli i kredisë për individë ka shfaqur një përmirësim të qëndrueshëm të normave të rritjes. Ky përmirësim ka reflektuar si kërkesën e lartë për financim nga individët, ashtu edhe kushtet financiare përgjithësisht lehtësuese të ofruara nga vetë bankat. Një ecuri të ngjashme ka pasur kjo kredi edhe në vendet e rajonit.

Financimi i bankave për individët ka vijuar me ritme të larta, ku rritja mesatare vjetore prej 14.7% në gjashtëmujorin e parë ishte rreth 1.7 pp më shumë se në atë paraardhës. Kjo rritje është mbështetur gjerësisht nga financimi në lekë i individëve. Rritja vjetore e këtij portofoli me rreth 22%, kompensoi edhe tkurrjen që shfaqti kreditimi në valutë me rreth 1%. Ruajtja e kushteve lehtësuese financiare në lekë dhe më të favorshme se sa atë në euro së bashku me vijimin e tendencës mbiçmuese të lekut ndaj euros duket se kanë mbështetur më tej zhvendosjen e kredisë së individëve drejt monedhës vendase.

Në një këndvështrim më afatgjatë, që prej fillimit të zbatimit të masave makroprudenciale për kreditimin e individëve në monedhën e të ardhurave

(2018), pesha e kredisë për individët në lekë ndaj totalit është rritur me rreth 8 pp. Ndërkohë, fenomeni i vërejtur gjatë vitit 2023, ai i zhvendosjes së kredive nga euro në lekë duket se është pakësuar ndjeshëm. Kështu, vlerat e këmblyera kanë qëndruar në nivele të ulëta gjatë gjashtëmujorit të parë.



Sipas qëllimit të përdorimit vihet re se kredia për blerje banesash dhe ajo për konsum kanë shfaqur përmirësim të normave me një rritje vjetore prej 1.5%, ose rreth 4 pp më shumë se ajo e vërejtur në gjashtëmujorin e fundit të vitit. Megjithatë, dinamikat afatshkurtra midis tremujorëve në këto dy segmente kanë ndryshuar. Kredia konsumatore e filloi vitin me tendencë rritëse të shpejtë, e cila u ngadalësua në tremujorin e dytë. Kurse dinamika e portofolit të kredisë për banesa ishte e ndryshme, duke ndikuar në një rezultante me një rritje të balancuar të segmentit të kredisë për individë. Në fund të periudhës në analizë, kredia për banesa përbën rreth 67.4%, rreth 1 pp më shumë se fundi i vitit 2023, ndërsa ajo për konsum ruajti të njëjtën peshë në rreth 28.2%³.


Normat e interesit për kreditë në lekë të individëve në pjesën e parë të vitit janë shfaqur përgjithësisht të qëndrueshme dhe me prirje të lehtë rënëse në muajt maj dhe qershor. Kjo tendencë është influencuar në një farë mase edhe nga ecuria e yield-it të bonos 12-mujore, i cili përdoret gjerësisht në indeksimin e pjesës më të madhe të kredive të kësaj kategorie. Interesi i kredisë hipotekare në euro ndërkohë është rritur këto muaj. Ky zhvillim ka sjellë edhe zgjerimin e diferencialit të interesave me kredinë në lek, i cili vijon të jetë në terren negativ.

Interesat e kredisë në lek për individë janë ulur krahasuar me tremujorin e parë, duke iu afruar vlerave mesatare të vitit të kaluar. Pas një fillim viti të karakterizuar nga një rritje e lehtë kryesisht si rrjedhojë e përcjelljes së rritjes së normës bazë (në muajin nëntor të vitit të kaluar), interesat e kredisë për individë kanë shfaqur prirje rënëse në muajt e fundit. Interesi mesatar për kredinë konsumatore në tremujorin e dytë rezultoi 9.5% nga respektivisht 9.7% dhe 9.6% që ishte në dy tremujorët paraardhës.

³ Ndërkohë që kredi të tjera përbëjnë pjesën e mbetur prej 4.4% të portofolit, lehtësisht më e ulët se në vitin 2023.

Interesi i kredisë për blerje banese zbriti në 4.1% nga 4.5% që ishte një tremujor më parë dhe mesatares 4.2% të vitit të kaluar. Edhe interesat për overdraft-e kanë regjistruar një rënie të lehtë krahasuar me vitin e kaluar (12.4% në 6-mujt e parë nga 12.6 vitin e kaluar). Analiza sipas periudhës së fiksimit fillestar të normës së interesit tregon se tek kreditë me fiksimit fillestar deri një vit, interesat janë në kahun rënës në këtë pjesë të parë të vitit (3.5% në tremujorin e dytë nga 4.3% dhe 4.1% respektivisht në dy tremujorët paraardhës).


Grafik 13. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesi mesatar i kredisë së re në euro për individët ka vijuar të rritet duke regjistruar 5.8% në tremujorin e fundit nga 5.5% një tremujor më parë dhe mesatares 4.7% të vitit të kaluar. Ndryshe nga interesat e kredisë hipotekare në lekë, analiza sipas fiksimit fillestar të interesit tregon se për kredinë në euro, interesat janë rritur tek të dyja kategoritë. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekare në lekë dhe asaj në euro është zgjeruar më shumë këtë 6-mujor.

Grafik 14. Ecuria e normave të interesit për kreditë hipotekare në euro për individët




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kushtet dhe termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve mbeten lehtësuese, pavarësisht sinjaleve të moderuara për një kujdes të shtuar të bankave ndaj këtij segmenti.


Në përgjithësi kushtet joçmim të bankave për kredi për individë mbeten lehtësuese, pavarësisht shenjave të dhëna nga një nga bankat e sistemit për rritjen e prudencës. Të ndikuara nga kjo bankë, standardet e kreditimit për individët raportohen lehtësisht më të shtrënguara krahasuar me gjysmën e dytë të vitit të mëparshëm, në reflektim të gjykimin të bankave mbi aftësinë paguese të kredimarrësve dhe zhvillimeve aktuale e të pritura në tregun e banesave.

Kushtet dhe termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve mbeten thuajse të pandryshuara në gjysmën e parë të vitit 2024. Ndërkohë, edhe raporti i kredive të refuzuara ndaj totalit u zvogëlua duke konfirmuar gatishmërinë e bankave për akomodimin e kërkesës. Bankat vijuan të mbështesin kërkesat për kredi të individëve nëpërmjet miratimit të kredive në madhësi më të lartë, ndërkohë që nga ana tjetër vijuan me shtimin e kërkesave për kolateral në raport me kredinë e marrë.



Kredia për individë në vendet rajonit, e cila dha shenjat e para të rikuperimit që në gjysmën e dytë të vitit të kaluar, ka shfaqur përmirësim në drejtim të rritjes edhe në pjesën e parë të vitit. Mes vendeve të Ballkanit, Kosova, Bullgaria, Shqipëria dhe Kroacia spikasën për vijimësi të normave të larta të rritjes së saj. Kredia për individë është rigjallëruar edhe në Serbi e Rumani, ku ishte ngadalësuar ndjeshëm gjatë vitit 2023. Në vendet e EQ-së, rritja e kredisë për individë ka vijuar e qëndrueshme në Çeki dhe është përmirësuar në Hungari. Ndërkohë në Poloni ka kaluar në një territor pozitiv pas tkurrjes së regjistruar në vitin 2023. Informacioni i përfutur nga VAK-u në vendet e rajonit sugjeron përmirësim të mëtejshëm të rritjes së kredisë për individë gjatë këtij viti, të nxitur kryesisht nga kredia hipotekare.


Grafik 16. Kredia për individë në rajonin e Ballkanit dhe të Evropës Qendrore



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; llogaritje të stafit.

Normat e interesit për kreditë e reja për individë, sikurse ato për biznese, kanë filluar të bien në mënyrë më të dallueshme në vendet e EQ-së, atje ku rritja e tyre rezultoi edhe më e lartë. Në segmentin e kredisë konsumatore, ato kanë ruajtur nivele relativisht të qëndrueshme me nivelet e gjashtëmujorit të kaluar në pothuaj të gjitha vendet e Ballkanit, me përjashtim të Serbisë dhe Rumanisë, ku kanë regjistruar rënie. Interesat e kredisë hipotekare në gjashtëmujorin e parë kanë rënë në Rumani dhe në Maqedoninë e Veriut, janë rritur në Serbi, ndërsa në vendet e tjera janë luhatur në nivele të ngjashme me ato të gjashtëmujorit të mëparshëm.

Grafik 17. Normat e interesit për kreditë konsumatore dhe ato hipotekare të individëve, në monedhë vendase



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; llogaritje të stafit.